

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Emine Kaçiku dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit-propozuesit Avokati i Popullit i R.Kosovës, kundër të paditurës – Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i vendimit-aktit administrativ, duke vendosur lidhur me kërkesën e të paditurës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.451/2017 dt.20.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 26.12.2017, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.451/2017 të datës 20.10.2017.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.451/2017 të datës 20.10.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore-Dep.administrativ A.U.nr.1373/2017 dt.11.09.2017, me të cilin është aprovuar kërkesa e paditësit-propozuesit Avokati i Popullit i R.Kosovës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurës ZRRE V nr..... dt....., deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër aktvendimeve të kontestuar, të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.451/2017 dt.20.10.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dep.administrativ A.U.nr.1373/2017 e paditura ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe të shkeljes së dispozitave të procedurave, me propozim që të aprovohet kërkesa, të prishen aktvendimet e kontestuar dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, apo të dy vendimet të ndryshohen dhe të miratohet ankesa e të paditurës si e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktvendimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.451/2017 dt.20.10.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës ZRRE, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dep.administrativ A.U.nr.1373/2017 dt.11.09.2017, me të cilin është aprovuar kërkesa e paditësit-propozuesit Avokati i Popullit të Kosovës, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurës ZRRE V nr..... dt....., deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e shqyrtuar kërkesën e paditësve gjen se gjykatat e instancës më të ulët kanë bërë aplikimin e drejtë, duke e aprovuar si të bazuar propozimin e paditësit - Avokati i Popullit i R.Kosovës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurës ZRRE V nr..... dt....., deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Neni 22.2 i Ligjit për Konfliktet Administrative parasheh se shtyrja mund të bëhet me kërkesën e paditësit, organi,akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Ndërsa me dispoziten e nenit 22.6 të të njëjtit ligj përcaktohet se paditësi mund të kërkoj nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor , sipas kushteve të paraparë në nenin 22 par.2 të LKA-së .

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës ZRRE, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ A.U.nr.1373/2017 dt.11.09.2017 me të cilin është aprovuar propozimi i paditësit-propozuesit Avokati i Popullit të Kosovës, lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurës ZRRE V dt....., deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, pasi që ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm qytetarëve të Kosovës i cili vështirë do të riparohej, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të plotë dhe të drejtë kanë zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për konfliktin administrativ. Janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë të drejtës materiale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 lidhur me nenin 22.2 dhe 6 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ-UZVP nr.68/2017 dt. 26.12.2017

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Procesmbajtësi,

Sherif Krasniqi

Përktheu: Ferid Abazi